



KRYEMINISTRIA

AGJENCIA SHETËRORE E PROGRAMIMIT STRATEGJIK DHE KOORDINIMIT TË NDIHMËS (SASPAC)

Draft-Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2021-2030 (SKZHIE III)

Njoftim për konsultimin publik

(Draft) Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2021-2030 (SKZHIE III) është dokumenti kryesor strategjik kombëtar që mbështet zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të vendit, duke siguruar përmbushjen e standardeve dhe progresin në procesin e integritimit evropian të vendit.

SKZHIE 2021-2030 është një platformë kyçe e cila harmonizon dhe pajton agjendën zhvillimore me proceset integruese të vendit, duke përmbledhur vizionin, përparësitë dhe objektivat madhore kombëtare për periudhën deri në vitin 2030. SKZHIE III gjithashtu shërben si dokument strategjik qëndror dhe orientues i cili siguron prioritizimin e politikave për strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale, programeve IPA si një instrument financimi për vendin nga Bashkimi Evropian, si edhe financimit të donatorëve të tjerë të huaj.

Qëllimi i procesit të konsultimit publik:

Mbledhja e rekomandimeve dhe komenteve nga qytetarët, shoqëria civile, partnerët socialë dhe të zhvillimit, mbi adresimin e sfidave të progresit dhe integritimit evropian, orientimin e reformave të vendit në nivel afatmesëm dhe afatgjatë, si dhe pasurimin e këtij dokumenti themelor me mendimet dhe opinionet publike mbi reformat dhe përparësitë strategjike të vendit.

Ju ftojmë të dërgoni komentet dhe rekomandimet tuaja, brenda 30 ditëve kalendarike, në adresën elektronike: kelvin.strazimiri@saspac.gov.al ose në adresën postare:

Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës
(SASPAC), Kryeministria, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr.1, Tiranë, Shqipëri
